



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT**

Nr. prot.

Tiranë, më, 23.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion i Oficines (Ndertim Montim)

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Pune ndertimi: 45000000-7

1. **Vlera e Fondi limit: 19,209,941.9** (nentembehjete milion e dyqind e nentemijee nenteqind e dyzet e nje pik nente) lekë pa TVSHvënë në dispozicion nga Buxheti afat mesëm 2024 – 2026, Bashkia Tiranë.

Argumentimi: Bazuar në preventivin e projektit nga Operatori ekonomik fitues (studim projekti), te mbështetur në cmimet e pasqyruara ne VKM Nr. 629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar .

I mbajtur sot më date **23.10.2024**, në DPPGJ – Tirane në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2 dhe 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar si dhe sipas rekomandimeve te APP Nr. 5168 date 18.07.2024, Autoriteti Kontraktor, DPPGJ, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek projekt-zbatimi i studios se shpallur fituese, si dhe nga grupi i punës i ngritur me urdhër Nr. 606 Prot datë 04.10.2024 për e kriterëve te vecanta teknike, të procedurës ne reference.

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e perzgjedhjes se ofertuesve, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën perkatese DST –ve, kriteret, të cilat

u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas Shtojcës 8 të DST**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike , grafikun e punes, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëlliminkryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore

(2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës ku vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomike të jetë jo më e vogël se **40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesëmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjejnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2021,2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesëmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjejnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë

objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit.

SHENIM: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE), çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës.

Lidhur me këtë kriter, shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 nga të gjitha vendet në të cilën është regjistruar sipas QKB apo nga të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet në këto vite.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar.

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 606 prot date 04.10.2024 specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **50% e vlerës së përllogaritur të kontratës** që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore për këtë situacion,
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore për këtë situacion,
 - Akt kolaudimi objekti.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, **Rekomandimit nr. 1797/1 prot date 10.03.2022 i APP-së**. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në

ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike2. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punime të përgjithme ndërtimi:

- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP-3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industrial, veshje fasada.
- NP-7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje.
- NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të

lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punime specila ndërtimi:

- N.S -1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- N.S-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- N.S -8 A Ndërtime parafabrikat, beton arme, struktura metalike dhe druri.
- N.S-18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr.42, dt. 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si mëposhtë:

NP-1 A	Punime gjurmimi në tokë	Seksioni 1. Punime dheu 2. Punime gjurmimi	0-20 mln	414,023.2
NP-3 A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada	I gjithë objekti është rikonstrukcion	0-20 mln	20,499,320
NP-7 A	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi dhe vaditje	2. Ujësjellës e kanalizim i jashtëm 16. Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje	0-20 mln	471,013.69
NP-11 A	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	17. Instalime për ndriçim 18. Analiza jashtë liste	0-20 mln	1,019,883.8

N.S –1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	14. Prishje	0-20 mln	26,762.90
N.S-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre	16. Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje	0-20 mln	334,322.25
N.S-4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale ndërtuese druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike	9.Punime hidroizolimi dhe çatite 10.Punime murature tulle 11.Punime bojatisje 12. Punime tavani dhe suvatimi	0-20 mln	3,880,391.18
N.S -8 A	Ndërtime parafabrikat, beton arme, struktura metalike dhe druri	5. Punime shtresash 2 6. Punime betoni dhe b/a 7. Punime hekur betoni	0-20 mln	8,131,937.27
N.S-18 A	Punime topogjeodezike	1.Punime dheu 4.Punime shtresash 8. Nënshtrësia dhe shtresa në territorin e ndërtesave 15. Punime gjurmimi	0-20 mln	2,246,239.35

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale të shoqërisë që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr.42, dt. 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin'

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **drejtuesin teknik të punimeve në objekt, inxhinier ndërtimi**, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi **për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar** nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionet e mëposhtme:

- a. Librezë pune.
- b. Kontratë pune e vlefshme.
- c. Diplomë.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në ligjin nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, kreu V, seksioni III, neni 39, pika 6, gërma c.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e drejtuesit teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi udhëzimi nr. 2, dt. 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", konkretisht pika 1.2 ku citohet se drejtuesit ligjorë dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi si dhe pikës 2.1. Në këte pikë (2.1.) citohet se drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që drejtuesi teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në VKM nr. 42, dt. 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2 ku përcaktohet se papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë - marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet

të disponojë licencë për mbikqyrje ekolaudim të punimeve të zbatimit dhe pika 2, “elementët e licensës”, gërma c, ku citohet se licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për drejtuesin teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 30 (tridhjetë) persona, të cilëtduhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin edokumenteve provuese.

Argumentim:Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr.162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet:

- Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një

tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 30 punonjës, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", ndryshuar, me VKM nr. 631, dt. 26.10.2018. Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rreth 20% të kostos.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për të paktën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi,
- 1 (një) inxhinier hidroteknik,
- 1 (një) inxhinier elektrik,
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune të vlefshme.
- Diplomë.
- Librezë pune si dhe të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- ❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedurë të shpallura fituese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve.

Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Drejtuksi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivisht të punimeve, nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë projektin e zbatimit si dhe preventivin e punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit, inxhinierë të kërkuar si më sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që drejtuesi teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në VKM nr. 42, dt. 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2, ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit dhe pika 2, "elementët e licensës" gërma c, ku citohet se licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë.

Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.

Duke marrë në konsideratë projektin e zbatimit si dhe preventivin e punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Inxhinieri i ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projekt.
- **Inxhinieri elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri topograf/gjeodet/markshajder**, është përgjegjës për piketimin e sheshit përpara objektit dhe për zbatimin e saktë të punimeve, lidhur me zërat e prishjeve dhe gërmimit në preventiv.

- **Inxhinieri hidroteknik është përgjegjës** për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

2.3.6.Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) arkitekt.**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme.
- Diplomë.
- Librezë pune.
- CV.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, dt 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar duke marrë në konsideratë projektin e zbatimit si dhe preventivin e punimeve rezulton se si pjesë e projektit është dhe projekti arkitektonik i objektit për të cilën është i domosdoshëm arkitekti për zbatimin e saktë të punimeve arkitekturore.

2.3.7Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, dt. 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, dt 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

- ❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.7 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedurë të shpallura fituese.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë:

- Diplomë.
- Certifikatat e cituara më sipër.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6 c, të VKM nr. 285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 dt. 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, dt. 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", si dhe ligjit nr. 10431 dt. 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010, është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr. 312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar, person fizik apo juridik, për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.8Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional, certificate, diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për **3 muajt e fundit të deklaruar nga** data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Punonjës staf teknik

- **1 (një) teknik ndertimi**
- **2 (dy) elektrikist**
- **2 (dy) hidraulik**
- **2 (dy) karpentier**

- **2 (dy) hidroizolues**
- **2 (dy) suvatues**
- **2 (dy) pllakashtrues**
- **1 (nje) bojaxhi**
- **2 (dy) punonjës gipsi**
- **2 (dy) specialist për strukturat metalike**
- **2 (dy) punonjës skelerie**
- **2 (dy) punonjës për dyer dhe dritare.**

Punonjës manovrator/shofer

- 1 (një) punonjës eskavatorist,
- 2 (dy) shoferë me leje drejtimi kategoria C.

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i çertifikatës/diplomës	Nr. nipt (në rast se lëshuesi është institucion privat)	Numri i çertifikates/diplomës
1.					
2.					
etj.					

Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin:

- kontrata e punës e vlefshme,
- dëshmi/çertifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët,
- ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme,
- të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.3.

Për punonjësit manovrator/shofer duhet të paraqitet:

- kontrata e punës e vlefshme,

- dëshmi e aftësisë profesionale/patentat, e vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse
- dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në ligjin nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,i ndryshuar, kreu V, seksioni III, neni 39, pika 6, gërma ç. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike të cilat do publikohen së bashku me dokumentat e tenderit, si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional, certifikatë, diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në regjistrat profesionale të AKAFP-së. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të manualit të ndërtimit miratuar me vendim nr. 629, dt. 15.07.2015, ndryshuar, me VKM nr. 631, dt. 26.10.2018. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.9. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë lëshuar nga QKL, “Kodi III. 2. B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 538, dt. 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, dt. 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar dhe ligji nr. 52/2020

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 10/448, dt 14.07.2011”, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, ku parashikohet se leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1 të këtij ligji.

Në shtojcën 1 është listuar edhe veprimtaria “menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, dt. 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se QKL lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III. 2. B të fushës III të VKM nr. 538, dt 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga institucioni përkatës.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, veprimtaria e nënkategorisë III. 2. B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim,transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, si “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10 km”.

2.3.10 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Kandidati/ofertuesi duhet të disponoje makineritë dhe mjetet si vijon në pronësi ose me qera.

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Autovinç deri në 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autobetoniere	cope	1	Në pronësi ose me qera
6	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Trapano	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Betoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Eskavator 0.25 m ³ me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Miniekskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera

12	Vibrator	copë	2	Në pronësi ose me qera
13	Elektrosaldatriçe	copë	2	Në pronësi ose me qera
14	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Makineri për prerje hekur ndërtimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Makineri për kthim hekur ndërtimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Skela 1000 m ²			Në pronësi ose me qera
19	Nyje betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Të paraqiten pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- kokore minimumi 10 (dhjetë) copë,
 - jelekë minimumi 10 (dhjetë) copë,
 - prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë,
 - komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 1 (një) copë,
 - tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë,
 - karroca dore minimumi 5 (pesë) copë.
- a. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni, taksat vjetore dhe leja e transportit.
 - b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet krahas dokumentave të përcaktuara në pikën a, me sipër cituar edhe kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
 - c. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qerasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
 - d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 8, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Mos plotësimi i këtij kriteri përbën kusht për skualifikim.
 - e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 8, në çdo kohë deri në përfundimin e

kontratës nga Autoriteti Kontraktor. Mos plotësimi i këtij kriteri përbën kusht për skualifikim.

- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas shtojces 8, në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor. Mos plotësimi i këtij kriteri përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6 d, të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.11 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë

- a. **ISO 9001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO.
- b. **ISO 14001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor), ose ekuivalente. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO.
- c. **ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë), ose ekuivalente. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit Autoriteti ose Enti Kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se Autoriteti/Enti Kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu XI, neni 88, pika 3, ku cilësohet se secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikime ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Për sa më lart, njësia e prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zërat e parashikuara sipas preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e ofertuesve me çertifikatat e kërkuara sipas pikës së mesipërme gërma a dhe c, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.12 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin grafikun e punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi Financimi është parashikuar në buxhetin **2024-2026**, pra vlera e parashikuar e kontratës është **3 (tre) vjeçare**, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë

operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT: